REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ

KUVENDI I KOMUNËS PEJË

I.Numër: 01-060/01-52504
Pejë, datë: 31 Korrik 2026

P R O C E S V E R B A L

Nga takimi i –**VI- të** i rregulltë i Kuvendit Komunal Pejë, i mbajtur me: **31 korrik 2026** me fillim në orën 10:00 h.

Takimi u mbajt në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.

Në takim prezantojnë: përpos anëtarëve të kuvendit të komunës, kryetari i komunës z. Gazmend Muhaxheri, nënkryetari z. Fatmir Asllani; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj; drejtorët e SHCK-së, z. Avni Gashi, udhëheqës i sektorit të kuvendit, zyrtare administrative znj.Donjeta Morina: përfaqësuestë ZIP-it, përfaqësuesit të OJQ-ve dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike.

Në vazhdim takimin e kryesoi; kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj, ku e hapi diskutimin për rendin e ditës dhe i sqaroj pikat të cilat janë vendosur në rend dite, pastaj konstatoj se janë 35 anëtarë prezent. Në bazë të listës që jeni nënshkruar të gjithë anëtarët janë prezent ndërsa kërkoj falje për shkak të mosfunksionimit të sistemit elektronik ne duhemi që të votojmë me ngritje dore.

Unanimishtë nga të gjithë anëtarët prezent, u miratua ky rend dite me propozimin që u dha nga kryesuesi:

REND DITE

1. Aprovimi i rendit të ditës.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 29.06.2026.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetimit të Komunës së Pejës dhe participimi nga qytetaret (fermerët përfitues) në projektin furnizim me mekanizëm bujqësor – 65 Traktorë.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për formimin e grupit punues për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2027.
5. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2026.
6. Shqyrtimi i raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2026.
7. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2025 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2025.

8. Shqyrtimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmerisë dhe testit të maturës.
9. Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç janë pranuar:
10. Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

1.Pjesëmarrja në takim e anëtarëve të kuvendit dhe mungesat.

Nuk ka pasur.

2.Pjesëmarrja publike dhe delegacionet
Nuk ka pasur.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit të Kuvendit të Komunës së Pejës dt. 29.06.2026.
Nga të gjithë anëtaret prezent me 19 votë pro, 6 votë të përmbajtur, 10 anëtar nuk marin pjesë në votim, miratohet procesverbali me vërjetjet dhe sugjerimit që u dhanë nga z.Berat Ganiqi në emër të Lëvizjes Vetvendosje.

4.Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetimit të Komunës së Pejës dhe participimi nga qytetaret (fermerët përfitues) në projektin furnizim me mekanizëm bujqësor – 65 Traktorë.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: e kemi një pikë që e kemi diskutu edhe në KPF. E keni marrë një material paraprakisht nga drejtoria e bujqësisë. Fjala është për përkrahjen e fermerëve dhe participimin që duhet ata në bazë kushteve dhe kritereve që ka drejtoria për bujqësi. Po hapi diskutimin për anëtarët e kuvendit nëse kanë për këtë pikë.

Z.Naim Bytyqi: duke marrë parasysh se bujqësia është një ndër digasteret më të mëdha të hyrjes buxhetore në nivelin qëndror po ashtu edhe në nivelin komunal. Tek çështja e mekanizmit bujqësor, pra dhënies së 65 traktorëve, unë e kam ngritur këtë çështje dhe po e vazhdoj edhe sot! Fillimisht drejtoria për bujqësi i ka qit disa kritere të cilat fermerët, aplikantët duhet të ju përmbahen atyre kritereve. Unë konsideroj se një pjesë e madhe e atyre kritereve nga aplikantët, nga përfitues e traktorëve janë shkelë. Listën e përfituesve e keni parë të gjithë. Një ndër kriteret të cilat ka qenë se sa tokë duhet me pas fermeri për ta fituar traktorin e keni parë. Një ndër kriteret është se fermeri nuk duhet të jetë fitues të paktën tre vite nga grantet qeveritare. Unë këtu kam një listë kur për shembull një rast është përfitues në 2025 vula është e 2025-es. Do të thotë kjo konsideroj se është shkelje e kritereve. Një shkelje tjetër ne e diskutuam edhe në Komitet për Politikë dhe Financa. Çmimi i këtij traktori të cilin e kanë marrë fermerët në treg ka qenë pikërisht ky operator Haxhi Jaha ka qenë 9.800€, që mundeni me pa ka mujt me shku me ble gjithkush. Ndërsa te komuna është faturuar 10.730€. Ne diskutuam edhe në Komitet për Politikë

dhe Financa, drejtori asesi nuk ka mund me u bind. Unë me këtë çështje jam zotu se nuk do të bëj politikë, por kam me çu deri në fund këtë çështje. Janë ato organe të cilat kanë me u marrë me këtë punë se a ka pas shkelje a jo. Unë e pretendoj se ka pasur shkelje dhe i kam dëshmi se ka pas shkelje. Andaj meqënëse traktorët nuk janë shpërndarë të gjithë, unë mendoj se duhet me u kthy ato çka kanë mbet dhe me përfitu fermerët të cilët e meritojnë, e jo biznesmen ose ata fermerët të cilët nuk e meritojnë. Ne kemi dëshmi të ankesave këtu i kanë prezent të cilët i plotësojnë kushtet shumë më shumë se këta të cilët kanë përfitu. Sa i përket dhënies participimit për 40% të fermerëve kjo është dasht edhe me u ul krejt. Nëse ti do sikur në të gjitha vendet e Evropës me i ndihmu fermerit, atëherë traktorin duhesh me ja dhënë falë dhe me përcjellë se a po e mban a po shfrytëzon. Parimisht duhet me j'a dhënë atij cili e meriton edhe i vyn. Andaj unë kërkoj mos me marrë këtë punë me shaka, se është marrë prej fillimi kërkoj që të bëhet ndryshim për herë të fundit. Po e përsëris sepse kjo punë ka me shku deri në fund edhe nuk ka me dalë mirë kjo punë.

Z.Ardit Berisha: sot nuk po diskutojmë vetëm për ndarjen buxhetore për blerjen e 65 traktorëve, sot po diskutojmë për një çështje shumë më të madhe. Po diskutojmë për filozofinë e zhvillimit të bujqësisë në komunën e Pejës dhe për mënyrën se si po i shpërndajmë paratë e qytetarëve. Dua ta bëj shumë të qartë që në fillim ne si Lëvizje Vetëvendosje nuk jemi kundër fermerëve nuk jemi kundër mekanizimit bujqësor dhe shpërndarjes së tyre, pra nuk jemi kundër traktorëve. Përkundrazi fermerët meritojnë mbështetje edhe më të madhe, por detyra jonë si opozitë pra nuk është të duartërkasim çdo shpenzim publik. Detyra jona është të presim nëse paratë e qytetarëve po përdoren në mënyrën më të mirë të mundshme. Kontrata që kemi sot para nesh parasheh furnizimin me 65 traktorë me një vlerë prej 697.450€ ku komuna mbulon 60% të vlerës dhe fermerët 40%. Ky është një investim i konsiderueshëm, por ajo që na shqetëson nuk është kjo kontratë në vetvete na shqetëson drejtimi që po merr politika bujqësore e komunës së Pejës. Sepse vetë ekzekutivi ka deklaruar se deri në fund të mandatit synon të realizojë pra premtimin publik të cilin e ka pasur për shpërndarjen e 300 traktorëve. Nëse ky program vazhdon me të njëjtin model financiar, atëherë deri në fund të mandatit do t'i kemi investuar mbi 3 milion euro vetëm në mekanizëm bujtësor, pra vetëm me këtë mekanizëm bujqësor traktor. Dhe këtu lind pyetja që duhet t'ia bëjmë vetes. A është ky prioriteti më i mirë për zhvillimin e bujqësisë në komunën e Pejës? Sepse fermeri nuk ka nevojë vetëm për traktor, fermeri ka nevojë për ujë, ka nevojë për sisteme moderne të ujitjes, ka nevojë për subvencionim të farës, të plehrave, ka nevojë për subvencionim të litres së qumështit, kërkesë e cila ka qenë e jona tash e dy muaj .
Ka nevojë për qendra grumbulluese, ka nevojë për frigorifer për ruajtjen e prodhimit, ka nevojë për rrugë bujqësore për mbështetjen për blektorinë, ka nevojë për sigurim të prodhimit, ka nevojë për treg ku ta shes produktin e tij. Nëse këto nuk zgjidhen atëherë dhe traktori sado i nevojshëm të jetë nuk e zgjidh problemin themelor të fermerit. Në vendet e Ballkanit dhe Bashkimit Europian bujqësia nuk zhvillohet duke investuar vetëm në një instrument. Atje financohet i gjithë zinxhiri i prodhimit investohet në mekanizma, por njëkohësisht investohet edhe në ujitje, në përpunim, magazinim, në qendra grumbulluese, në inovacion, në këshillim profesional, në zhvillimin e tregut, sepse qëllimi nuk është të shpërndash sa më shumë makineri. Qëllimi është të rrisësh prodhimin, të ardhurat dhe konkurueshmërinë e fermerit. Kjo është filozofia që ne si Lëvizje Vetëvendosje besojmë që duhet ta ketë edhe komuna e Pejës. Prandaj nuk themi të ndalet mbështetja për mekanizim përkundrazi ne themi që kjo çështje duhet të jetë pjesë e politikës bujqësore. Por nuk duhet të përqëndrojmë pothuajse të gjithë potencialin financiar në një masë të vetme. Mendoj që duhet të kemi një program më të balancuar, të vazhdojmë mbështetjen për

fermerët, por paralelisht të investojmë shumë më shumë në sistemet e ujitjes, në subvencionimin e inputeve bujqësore, në qendrat grumbulluese, në blektori, në pemtari me shumë ne sera, në mbështetjen e fermerëve të rinj, e cila është një pikë jashtëzakonisht kyçe për fermerët edhe për qytetin tonë, sepse një komunë serioze nuk e ka suksesin me numrin e traktorëve që shpërndan por me rritjen e të ardhurave të fermerëve, me rritjen e eksporteve, me numrin e të rinjve që vendosin të jetojnë edhe të punojnë me bujqësinë. Dhe për fund një pyetje që mendoj që meriton përgjigje nga ekzekutivi nëse deri në fund të mandatit planifikohet dhe investohet mbi 3 milion euro në shpërndarjen e 300 traktorëve, a mund të na thoni se çfarë analize ekonomike është bërë për të dëshmuar se ky është investimi me ndikim më të madh që mund të bëhet në bujqësinë e Pejës? Sepse ne besojmë se në mbi 3 milion euro mund të drejtohet një politikë shumë e gjithëpërfshirëse që do të prekte çdo fermer dhe çdo hall të sektorit të bujqësisë. Prandaj ne nuk e kundërshtojmë ndihmën përmerë. Ne e kundërshtojmë mungesën e një vizioni të balancuar për zhvillimin e bujqësisë. Një traktor është një mjet pune, nuk është politikë bujqësore. Politika bujqësore është ajo që i garanton fermerëve ujë, treg, mbështetje prodhim dhe të ardhura më të larta. Ky është vizioni i jonë.

Z.Shkumbin Prekaj: unë Arditin veç deshta me e pyet. A je pro bujqve a me i falimentu bujqit? Deri tash ne ke lodh me subvencione qumështit 7 cent kur tash bujku e merr një traktor përmbi 10.000€ vlerë je kunder tyre. Sera me qindra, sera në komunën e Pejë, friza me qindra, mbjellëse, kanale të ujitjes me kilometra edhe deponi e këto për me ruajt dredhëzat. Çdo send që e përmende ti deri tash është e pavërtetë. Nëse jeni ju veç për me kundërshtu çdo send në komunë, atëherë ne po çohem, s'po votojmë këtu, as spo rrim kurgjë hiç, po dalim jashtë krejt. Po nuk është kjo në rregull duhesh më së pari me dalë nëpër fshatra me i kqyr çfarë kanë marrë.

Z.Ardit Berisha: për kolegun asambleistë të LDK-së. Unë e bëra shumë të qartë në fjalimin të cilin e mbajta.Ne nuk jemi kundër ndarjes e këtyre mekanizmave bujqësore. Ne e përkrahim ndarjen e këtyre mekanizmave bujqësor, por nuk mendojmë që 3 milion euro të buxhetit të komunës së Pejës duhet të shkojnë vetëm në traktor. Për shkak se politikë e komunës së Pejës është që deri në fund të mandatit ndahen 300 traktorë. Kjo është një ngarkesa e madhe buxhetore për buxhetin e vogël të cilin e ka komuna e Pejës. Thashë më shumë sera, nuk thashë se nuk ka nda komuna e Pejës sera, por thashë edhe çështjet e tjera të cilat ne mendojmë si Lëvizje Vetëvendosje që ne e shohim ndërtimin e bujqësisë në komunën e Pejës. Ju e keni politikën e juaj, me atë politikë keni garuar dhe fitoni, po ne e paraqitëm vizionin tonë si Lëvizje Vetëvendosje si e shohim ne zhvillimin e bujqësisë. Kështu që tjetër herë me qenë më i vëmendshëm me e përcjellë më mire fjalimin tim e jo me u kap te çështje të tjera. Tek subevencionimi i litrës së qumështit e bëjnë shumë komuna Lëvizjes Vetëvndosje ku qeverisin apo të gjitha komunat normalisht që është politikë e jona si Lëvizje Vetëvendosje e kemi propozuar edhe në kuvendin komunal, edhe do të kishte qenë mirë që edhe asambleistet e kuvendit komunal ta mbështesin këtë nismë ajo është ndihmë për fermerin. Unë takohem çdo ditë me fermer edhe ata çdo ditë më pyesin se a po shtyhet përpara çështje e subvencionimit litres së qumështit. Ajo është mbështetje direkte një traktor i cili kushton 10.700€ e që fermeri duhet me pagu 5.000€ në rregull jam edhe te participimi jam në rregull. E kam thënë edhe në Komitetin për Politikë dhe financa jo 40 po 50% ndoshta për shkak që fermeri ndoshta kur kontribon ja din më shumë rëndësinë e mjetit të cilin ai e merr, e jo sikur fermerët e tjerë të cilët kanë përfitu edhe mekanizma e mbas një muaj dy muaj ke pasur në merjep mekanizma bujqësor. Pra jemi që të ketë mbikëqyrje dhe më të madhe të tyre shpërndarjes së këtyre mekanizmave.

Andaj të lutem kolegë kur të dëgjosh kur të foli, dëgjo me vëmendje për shkak se askund nuk thashë që jemi kundër ndarjes së 300 traktorëve.

Z.Shkumbin Prekaj: nëse e sheh në merjep një mjet bujqësor që ka dalë komuna, atëherë ti e ke obligim me shku në prokurori me deklar, jo veç me fol në foltore këtu e kam parë në Merrjep. Se aty ka traktora, ka friza në shitje se për atë punë është kur të folësh ti janë duke i subvencionuar veç traktor është e pavërtetë.

Z.Islam Husaj: unë tash mbeta në mjegul, nuk e di pikën e rendit ditë a e kemi shqyrtimi dhe miratimi i buxhetimit të komunës së Pejës për participim me qytetarët në projektin për furnizim 65 traktorë, a është 65 a 300? Nuk e kam qartë se po flitet për 300. Sot e kemi pikën e rendit të ditës për 65 traktore. A duam me i aprovu a s'duam me i aprvu, për të të tjerët flasim në takime të tjera.

Z.Tahir Shala: po filloj më së pari prej Arditit që e mbajta mend se ke i fundit. Kur të shtyp një tekst, në ChatGPT në fund tekstin e dytë e shtyp a ekziston diçka prej tyre që përmenda në Pejë, edhe të qet çka ka dhe çka s'ka. Seancën tjetër kur e shtyp këtë pjesën tjetër prej tyre çka i përmende çka ekziston në Pejë qendrën grumbullues e mjedrave e boronicave sa kemi eksportu si komunë ne Pejë, sa kemi shpenda serra, sa perime sa ato ne e kemi program që i kemi fituar 16.000 vota për asamble edhe nja 20.000 për kryetar. Ky është programi jonë lexo, që ka diçka që jemi duke zhvillu jashtë këtij programi, atëhere flasim. Por vete e chatin që këtë piken e dytë bëja se ai të kallëzon nëse ka të dhëna, se janë të dhëna publike ekzistojnë në chat. Tek pyetja e Naimit i kam thënë edhe atë ditë nuk ka diçka, po me këta du me bo politikë sot. Këtu po i drejtohna andej zonës kah më përfaqësojnë mua. Deri sot s'kem bë asnjëherë politik me projekt, sot du me bë politikë e kemi ujësjellësin e Lugut të Baranit. Pikërisht tash kryetar i Aleancës atëherë ka qenë asamblistë që e ka inicuar pretendimi i tij ka qenë që janë bërë shkelje ligjore janë çel kanale, u mshel kanali, nuk janë hy gypat e ka nisur për keqpërdorim financiar. Ka thirrë gazetar ka shku vetë në terren ka bë video, në fund ka dalë pretendimi për një leje mjedisore. Tash për me ja shpjegu pse s' e kemi marrë prej komunës leje mjedisore që u prolongu ky projekt. Në momentin që e kemi vendosur ne si komunë me çu me marrë ujë në gryk Shushicës është plani zhvillimor komunal, hartatzonale e parasheh ujin qatje ose me u bë pend me u grumbullu ose me u përdor uji për dy destinacione që ky kuvend e ka vendosur me qu atë ujë atje. Ndërkohë në 2019n u bo edhe vija e parkut zonimi ka qenë park, po s' ka qenë zënimi. U bë zënimi edhe vija e parkut i ka ra nder qaty ku kemi me marrë ujë na. Kjo është problem i Ministrisë së Linjeve që s'kanë pasur komunikim ndër vet edhe u dalë një gabim ligjor që ne si banorë atje kemi konsekuenca tash e sa vjet. Të vetmen që e kam mërzi te shtëpia kur thojnë blej ujë. Ky bën hajgare nëpër kafe tër ditën tu pi, e kanë çu kryetarin në prokurorisë speciale, janë hudh hetimet. E kanë çu Agronin në prokurorin në Pejë janë hudh hetimet. Asnjë defekt ligjor s'e ka pas. I kam thënë atë ditë në kuvend një pendë që e ka ndërtu komuna është thyer kur kanë qenë vërshimet në Asllan Qeshme. Veç du me thënë që politikë kur bëjmë du me bë mire, tash po bojmë mire për fermer tash atij o ka i pengon. Edhe mua po më pengon se jam duke shpërndar 65 për një komunë janë pak. Edhe që i kam thënë kryetarit ose du me rrit vitin tjeter ose po e ndalim krejt. Në janar janë 100, ka me u tejkalu 300-shin e mbani mend është fjalë publike. S'ka me mbet fermer që punon pa e marrë një traktor. Nuk mundesh me i degradu prej

kafeve tu pi kafe tër ditën ky meriton ky s'meriton. Ne politikë bëjmë një herë në katër vjet edhe i fitojmë apet të zgjedhjet.

Z.Naim Bytyqi: nëse unë ti përballem në organe a mundesh me faktu ti se unë e kam iniciuar problemin e Lugut të Baranit edhe unë e kam çu në prokurori? A ke mundësi ti me faktu? A mundesh unë ti bashkë një bankë aty ti andej unë këndej? A don me provu këtë? Mos fol gjëra çka nuk janë, as gazetarët si kam thirrë edhe pse për punë të këqija duhet me thirrë edhe gazetarët edhe prokurorinë asnjërën s'kam thirrë. Mos e ndërro temën nuk jemi ne kundër fermerëve, unë jam kundër kësaj pse po paguan 10.800 euro për çka po paguan? Paret e mia, janë taksat tona pse po paguan për traktorin e njëjtë pse referencat i ke çu për timon mekanik, ku përdoret timoni mekanik sot!? E sa i perket çështjes së Lugut të Baranit kur dush ballafaqohemi.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: duhesh me mësu ligjin e prokurimit se është i dyti mandat që je asambleist. Aty konkurron ai me çmimin që e ka, nuk jemi dalë ne me bler në pazar atje po ai ka konkuru me çmim edhe s'ka pas kriter tjetër.

Z.Naim Bytyqi: pse timoni makanik? Çka i ndihmon fermerit timoni mekanik duke qenë hidraulik?

Kryetari Gazmend Muhaxheri: karakteristikat i kanë lyp i kemi bo bashkë me fermerët i kemi diskutu me njerëz që kjo është shku në rregullë.

Z.Ardit Berisha: ne e kuptojmë që ekzekutivi sot është pak i acaruar ndoshta prej promshit edhe pse neve nuk na interesojnë zhvillimet politike në Lidhje Demokratike. Ne e dimë që jeni të irrituar te kjo çështje, po ajo që më shqetëson mua prej mbledhjes së fundit të komitetit për politikë dhe financa, drejtori i bujqësisë është këtu që po rreh gjyks lidhur me këtë çështje tha: çështja e ndarjes së 300 traktorëve më ka thirr kryetari më ka thënë çka s'ka bo kërkush në Kosovë me nda traktor, t'i ndajmë 3 milion euro buxhetit e qytetarëve te kjo çështje te mekanizmat bujqësor. Drejtor, nuk ke strategji ne jemi ka thojmë si Lëvizje Vetëvendosje për zhvillimin e bujqësisë në komunën e Pejës. Kjo është çështja kryesore që neve na shqetëson si Lëvizje, me i nda 3 milion euro vetëm në mjet të punës traktor për neve mundet me qenë edhe në rregullë. Ndoshta ka nevojë por e dimë se në fshatrat secila familje e cila merret në bujqësi e ka nga një traktor. Sa po i ndihmojmë ne fermierin si komunë e Pejës me një traktor që kjo është çështja. Sa po e zhvillojmë bujqësinë në komunën e Pejës me këta traktor e me gjithë këtë buxhet, këtu qëndron çështja. Të lutna ndrysho qasjen se edhe qasja nuk është në rregull prej ekzekutivit, ne jemi asamblista jemi zgjedhur me votë qytetarëve edhe besoj që ju si Lidhje Demokratike duhet me qenë pak më korrekt me kolegët asamblista.

Z.Berat Ganiqi: këtu debati është duke u zhvillu a duhen me meritu bujqit, a nuk e meritojnë, a duhet me i subvencionu, a nuk duhet me i subvencionu. E tash po t'i jap përgjigje edhe në emër të grupit të asambleisëtve të Vetëvendosjes edhe politikës tonë që po jemi që me u subvencionu krejt bujqit edhe fermerët që e meritojnë. Mirëpo me këtë politikën që po doni me participim unë po ju bëj një pyetje. A jemi duke ndihmu edhe atë bujkun që s'ka mjete me ble këtë traktor? A i ka 4.000€ një bujk për me shtu në participin, se ka prej bujqve që janë në gjendje shumë të keqe dhe nuk i ka këto 4.000€ me participim. Tash meraki im është në qëta 300 vetë nëse i marrin

300, sot 65 edhe ju keni premtu që i marrin deri në fund të vitit 300 tash u jep një zotim tjetër që tejkalohet. A ka me pas bujkë që veç i kanë mjetet edhe kanë me mundu me ble traktor edhe a jemi duke mujt me mbrri te qaj bujku që nuk i ka këto mjetet me ble këtë traktor, s'i ka qato 4.000€ qysh kemi me i ndihmu me shty përpara? Se ka biznesmen në mesin e këtyre bujqeve që e kanë arrit me nderë edhe me punë këtë pasuni, mirëpo çka jemi tu bë për atë bujkun që s'i ka mjetet?

Z.Shkumbin Prekaj: po mbase këta janë qaq korrekt, dy persona prej tyre shtatë muaj ditë kanë marrë pagë jashtë ligjit edhe në Hidro Drin edhe këtu mbasi janë qaq burra të mirë e spo merkan me paren publike të shtetit, atëherë këta duhet shtatë muaj ditë me i kthy paret mbrapa.

Z.Ardit Berisha: u bë një akuzë publike lidhur me çështjen e mbajtjes së dy pozitave edhe në Hidro Drin edhe në asamble komunale. Kjo është një akuzë edhe një shpifje nga ana jote te çështja e keqpërdorimit fjala për shkak që mbajtja e dy pozitave ajo veç se dihet ka qenë fakt edhe është fakt. Edhe sekretari i kuvendit edhe kryetari i kuvendit e kanë interpretimin për parandalimin e korrupsionit në Kosovë e kanë se vetë e kanë kërku, ku agjencia për parandalimin e korrupsionit thotë që ke të drejtë edhe kandidimin edhe mbajtjen e dy pozitave. Po ashtu po të kallëzoj dhe tjetrën ka aktvendim nga prokuroria themelore në Pejë e cila e ka mbyllur rastin te çështja e dyshimit se mbajtja e dy pozitave kemi aktvendim për hudhjen e kallëzimit penal, dhe e keni padin në gjykaten themelore në Pejë lidhur me ketë çështje.

Nga të gjithë anëtaret prezent me 19 votë pro, 1 votë e përmbajtur, 14 anëtar nuk marin pjesë në votim miratohet buxhetimi i Komunës së Pejës dhe participimi nga qytetaret (fermerët përfitues) në projektin furnizim me mekanizëm bujqësor – 65 Traktorë.

5.Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për formimin e grupit punues për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2027.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: ky komision përbëhet nga shtatë anëtarë siç e kemi praktikuar çdo vit. Plani i punës së kuvendit duhet të hartohet para fillimit të vitit dhe ky komision punon në renditjen e pikave të cilat janë në plan të punës dhe gjithashtu në këtë plan të punës presim që edhe nga ekzekutivi pikat e cilat i kanë që i sugjerojnë, gjithashtu edhe nga shoqëria civile që del në diskutim publik dhe anëtarët e kuvendit për planin e punës që është për vitin e ardhshëm, i cili duhet të miratohet në fund të këtij viti. Anëtarët këtij komisioni janë të subjekteve politike me përfaqësim siç jemi këtu në kuvend. Kryesusi shkon me automatizem dhe z.Avni Gashi nga sekretaria e kuvendit.

Anëtaret e propozuar:

1. Islam Husaj- LDK
2. Drin Veselaj-AAK
3. Hidajete Nikçi-LVV
4. Edonjeta Berisha- PDK

5. Muamel Dupljak – BSB

Nga të gjithë anëtaret prezent me 29 votë pro, 5 anëtar nuk marrin pjesë në votim miratohet formimi i grupit punues për Hartimin e Planit të Punës së Kuvendit të Komunës së Pejës për vitin 2027.

6.Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2026.

Z.Drin Veselaj: para se me fol për këtë pikë të rendit të ditës, e kërkova fjalën edhe në pikën e tjetër të rendit të ditës. Vërtetë është për keqardhje debati qysh po lëshohet në këtë kuvend. Asnjëherë nuk e pashë që këtu ka tendencë për me u diskutu për të mirën e qytetarëve, mirëpo veç me u lshu në gjëra personale. Ne jemi mësu, unë personalisht jam mësuar me juve që çdo dështim që e keni pas gjatë këtyre mandateve gjithmonë me akuzu të tjerët. Projektin Borea j'a ka ndal dikush, ujësjellësin j'u ka ndal dikush, traktorat j'u ndal dikush. Po veç po harroni që ju jeni përgjegjës për krejt këto dështime që i keni bërë deri tash. Po e them këtë në këtë pikë për shkak se e kemi edhe planin e punës për gjashtë mujorin. Kanë kaluar 14 vjet ju vazhdoni me na akuzu neve si opozitë për dështimet e juaja. Kryetari qe sa vjet duke u mar me Boren, na keni ndalë, ju jeni të forte, ai ministër ky minister, po unë e bëj se s'mundi me më ndal. Nuk e bëri 14 vjet ne jemi dëshmitarë që ky nuk mujti me bo, dhe në fund e pata thënë që e çoj flamurin e bardhë. Gjithashtu ujësjellësin kjo j'a ka nis me u diskutu qysh në vitin 2013, i kanë shti do gypa, i kanë heq do gypa, her e qojnë në Prizeren po asnjëherë nuk kanë dit ku kanë pas me lidh, dhe në fund del një e akuzon një asamblist i cili e ka obligim ligjor e kombëtar e njerëzor me shpërfaq atë çka mendon, që është në të keqen e qytetarëve. Edhe me pa qenë dikush prej neve kundër ujësjellësit, besoni që nuk kishin dalë me diskutu për atë pjesë, po veç e kishin lënë ashtu edhe s'kishit pas ju mundësi me akuzu kërkënd.

Pas një pauze të shkurt anëtaret e kuvendit kthehen në takim, përveq anëtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje

Z.Naim Bytyqi: fillimisht edhe unë në emër të Aleancës ju kërkoj falje fillimisht qytetarëve të Pejës për atë zhurmë që ndodhi në kuvend. Kryesues ne e diskutuam edhe në korridor unë tre fyerje të shpejta i mora prej teje në korridor. Po mirë kishte me qenë edhe ti me kërku falje në aspektin shoqëror unë po i pranoj, po mos kërkofsh falje e pranoj aspektin shoqëror që kemi qenë shokë dikur, por tash e mbas e vazhdojmë veç pjesën zyrtare. Pjesën zyrtare të kuptoj ti e ke në baza ligjore ke të drejtë me ndalë fjalën kur dalin prej teme, po edhe nëse gabon anëtari i kuvendit ti je ai që nuk bën me gabu!

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: unë nuk e di që e bëra ndonjë fjalë që ka ndiku me u lëndu dikush keq ose ndonjë fyerje në pjesën e pauzës, nëse kam bë ndonjë fyrje sinqerisht kërkoj falje.

Znj. Ilrijana Gafuri: raporti gjashtë mujor po besoj se nuk duhet të shihet si një dokument administrativ, por si një pasqyrë e performancës së institucioneve tona edhe si bazë për të vlerësu nëse premtimet ndaj qytetarëve po realizohen. Së pari do të ndalem te realizimi i investimeve kapitale. Sipas raportit deri në fund të muajit qershor është realizu 17.5% e buxhetit planifikum për investime kapitale dhe kjo përqindje është shqetësuese dhe ngre pikëpyetje serioze nëse

projektet e planifikuara do të mund të përfundojnë deri në fund të vitit. Në veçanti në sektorin e shëndetësisë realizimi i investimeve kapitale është vetëm 11.6%. Qytetarët kanë nevojë për pajisje funksionale, ambiente më të mira, shërbime më cilësore. Prandaj kërkoj sqarime konkrete cilat projekte janë vonuar, cilat janë arsyet dhe cili është afati për përfundimin e tyre? Po ashtu në raport për drejtorinë e shëndetësisë figurojnë 553 lëndë prej të cilave 516 janë ende në proces. Kërkoj të dimë në këtë raport se për çfarë lloj lëndësh bëhet fjalë dhe pse nuk janë përfundu ato, çfarë ndikimi ato kanë në ofrimin e shërbimeve shëndetësore tek qytetarët. Në raport paraqitet numri i vizitave prej 102 mijë e 91 por vetë raporti përmend edhe nevojën për shqyrtim të veçantë të tre ekipeve të urgjencës, duke përfshirë numrin e rasteve, kohën e reagimit të tyre, mbulimin territorial, shfrytëzimin e stafit dhe koston. Pra nuk mjafton të thuhet se shërbimi funksionon, por duhet të dimë a është ai efikas dhe sa kushton një rast i trajtuar. Për pajisje mjekësore janë paraparë 149.940€ ndërsa për servisim të pajisjeve 20.000€ kërkoj transparencë. Cilat pajisje janë ble deri tash? Cilat janë sevisuar dhe a janë aktualisht pajisjet funksionale për shërbime shëndetësore. Po ashtu janë është parapa gjithashtu kontratë prej 150.000 eurove për dy vite, pyetja është cilat shërbime po blihen jashtë QKMF-ve dhe pse nuk po kryhen nga kapacitetet publike nëse ato ekzistojnë? edhe nëse ato ekzistojnë atëherë duhet të paraqesin raportet e tyre. Plus e ka dhe një borgj drejtori i shëndetësisë të raportoj për asgjesimin e mbetjeve medicinale, të cilën është e treta ose e katërta herë që po kërkoj. Sa i përket shërbimeve, punëve komunale dhe shërbimeve publike, qytetarët presin përgjigje konkrete për projektet infrastrukturore domethënë cila rrugë, sa rrugë, sa trotuare, cili kanalizim, cili ndriçim.? Raporti i shërbimeve publike është më shumë si raport i procedurave sesa raportimi i rezultateve. Për qytetarin nuk është me rëndësi vetëm që një projekt është në tenderim. Raporti paraqitet kryesisht me këto terma, janë zhvilluar procedurat, është iniciuar, është në fazën e tenderimit, është planifikuar. Një rast konkret raport paraqitet projekti për muret mbrojtës në Dardani, Kapeshnicë dhe Xhemajl Kadë, por në gjashtë mujor është vetëm në fazën e tenderimit. Këto fraza të përdorura në këtë raportim thjesht nuk janë domosdoshmërisë edhe rezultate. Raporti gjashtë mujor duhet të na tregojë jo vetëm çfarë ka bërë administrata, por çfarë ka marrë qytetari nga puna e administratës. Inicimi i procedurës, tenderimi, planifikimi nuk konsiderohen të barabarta me realizim, prandaj edhe nuk merren si raport i një pune të suksesshme. Nuk mund të ndalem edhe mos ta përmend këtu deponinë e Sferkës. Kam prit që pas zjarreve të fundit edhe ndotjes së ajrit që ka përjetuar qyteti i Pejës, bile në raport të përfshihej një analizë me masa konkrete për këtë problem. Mirëpo siç po shihet kjo çështje ka mbetur ende jo me rëndësinë e saj. Qytetarët edhe ne e meritojmë të dimë se çfarë është bërë, çfarë do të bëhet dhe kush e mban përgjegjësinë? Kurse për bujqësinë e cila tash u bë sot mollë sheri, unë e kam vetëm një pyetje i kemi 500.000 euro të planifikara subvencionim të bujqësisë në gjysmën e vitit, deri në fund të qershorit realizimi është 0%. Tash nuk po mund me kuptu këta traktorë a janë ble me paret subvencionimit apo me paret të investimeve kapitale edhe pse në të dyja rastet edhe te investimet kapitale edhe te subvencionimet shuma e tabelës e paraqet si zero shpenzim. Edhe serat nuk janë vetëm këto, edhe serat 111 fermerë që kanë marrë sera dhe ato nuk po figurojnë, a janë prej investimeve kapitale apo prej subvencionimit. Si kuvend komune ne e kemi detyrim pra të kërkojmë transparence edhe efikasitet në realizimin e premtimeve që ju janë dhënë qytetarëve pa marrë parasysh programi i kujt edhe pse është qeverisës. Prandaj edhe pres përgjigje konkrete edhe me afate pak më të matshme edhe të dhëna më konkrete për secilin projekt edhe në secilin drejtorat. Unë po mendoj që këto raporte që po i paraqesin janë ndoshta copy past, i kanë tabelat e gatshme dhe veç i plotësojnë ato shërbimet të cilat i kryejnë, ato projekte të cilat janë, por duhet pak më detajisht. Në disa raste, disa drejtorate e kam pa në fund shkruan aty që raporti i

detajuar e ka drejtoresha e administratës. Unë po besoj që nuk duhet vetëm drejtoresha administratës të ketë qasje në një raport të detajuar. Për çka jemi ne këtu? Domethënë ta analizojmë çka mundem me gjet diçka që është keq, të kritikojmë në mënyrë konstruktive, të ndihmojmë edhe të përmirësohet ndonjë gjë, por gjithmonë duke e respektu, unë jam për me respektu rregullën e punës së këtij kuvendi.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: unë veç desha me potencu që të planifikume i kemi pas diku rreth 6 milion euro të hyra vetanake deri në gjashtë mujorin e pare, i kemi realizuar 2.9 milion euro dhe është send i mirë për komunën edhe për ekzekutivin. Domethënë që planifikimi ka qenë i drejtë edhe në rregull deri në fund të vitit, shpresojmë ta realizojmë synimin që e kemi pas për të hyra vetanake. Sa i përket projekteve o nis një byrokraci që pa zotim të mjeteve s'mundesh me i nis më projektet. Përpara ka qenë kemi nis një projekt që e ke pas të planifikuar, tash duhet edhe mjetet me i zotu. Kjo është veç vështirësimi i punës së administratës edhe ekzekutivit. Plus që mbartjen e të hyrave vetanake që i kemi pasur rreth 3 milion euro, nuk na kanë mbajtur deri në fillim të qershorit. Këto janë ato vështirësitë që i kemi si ekzekutiv, po prapë se prapë edhe përkundër obstruksioneve të shumta që i kemi prej pushtetit qendror po mundohem me i bo ball edhe me dalë në ndihmë qytetarve, dhe me i realizu ato projekte që janë të planifikume. Sa i përket deponisë në Sferkë, ne jemi munduar me shpjegu s'ka mujt me qenë në këtë raport se zjarri ka ndodhur më vonë se raport gjashtë mujor. Por komuna e Pejës përkundër krejt varfënisë që e kemi edhe mungesave buxhetore i kemi nda 3 milion euro, pushteti qendror me ministrin e planifikimit hapësinor nuk ka qenë i gatshëm me nënshkru marrëveshjen me Bashkimin Evopian. Për këtë arsye unë si kryetar komunës kam marrë obligim edhe i kam ndarë 3 milion euro, 1 milion i kemi nda sivjet, 2 milion janë vitin e ardhshem për me mund me u tenderu nëse nuk e kalon 12 milion euron, sepse 9 milion euro janë buxhet të Bashkimit Evopian. Procedurat e tenderimit në 2021-en kanë dështu ka arsyetime të ndryshme, jo o rrit çmimi, jo pandemia ne kemi hy në sanksione, tash të trijat janë të ndërlidhme. Nuk jam i prirur se po thonë kryetari po ju lë fajin, s'jam i prirur me lënë kurrkujt fajin, po që kjo ka ndodhur kjo është realiteti me deponinë e Sferkes. Projekte jam bërë tre herë. Nëntë vjet jam duke punu me këtë punë me mbri, buxheti i komunës nuk mundet me u nda me u realizuar deponia me buxhet komunal. Qeveria ka premtuar shumë, po kurrgjë s'ka bë edhe kriterin që e ka qitur domethënë që uji kur del prej asaj me qenë i pastër edhe me mund me u përdor për ujitje. Ketë 3 milion euron që nuk ka dasht me pagu qeveria e kam qit unë me pagu si kryetar i komunës, dhe ne e kemi votu atë në asamble komunale në planifikim të buxhetit. Për shëndetësi ato raporte është i bërë prej drejtorit e kthen përgjigjen drejtori kur të jetë në mundësi për me e kthy. Domethënë ne besojmë që deri në fund të vitit të realizojmë mbi 85% të shpenzimeve kapitale. Sa na duhet me qenë këtë garën për grantin e performancës. Po po shihet që përmbaruesit që prapë janë aktivizu për me i marrë të hyrat e komunës për paga dhe shujta që i kanë mbetur mësimdhënësve edhe stafit shëndetësor edhe këtë herë është aktivizu na i kanë marrë diku 360.000€ euro këtë vit. Nëse vazhdon kështu prapë edhe këtë vit që është granti i performancës, për shkak të kualifikimit nuk ka me mund me u marrë prej komunës së Pejës. Kjo është çka mund me thënë për këtë punë me rëndësi është që qytetarët i kanë kryer obligimet të hyrat vetanake janë du shku mire. Po shihet kënaqshmëria e tyre me punën e ekzekutivit është nivel dhe në ato hyra vetanake po mundohemi me i bë në projekte që realizohen edhe shkojnë në interes të qytetarëve.

7.Shqyrtimi i raportit i të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin e parë, janar - qershor 2026.

Znj.Diellza Berisha: në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e financave publike, paraqes si pikë të rendit të ditës raportin mbi realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore për periudhën janar-qershor 2026. Ky raport paraqet ecurinë e realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2026. Duke ofruar një pasqyrë të gjendjes financiare të komunës dhe nivelit të zbatimit të buxhetit të miratuar. Buxheti fillestar për vitin 2026 kap shumën prej 41,953.839 euro dhe strukturën e tij e përbëjnë. Granti qeveritar 35.770,288 euro, të hyrat vetanake 6.183.551 euro. Buxheti total për 12 muaj të vitit 2026 arrin shumën prej 46,073,925.44 që është për 4.120.086.44 më i lartë se buxheti fillestar. Struktura e buxhetit total është e ndarë si në vijim:. mjetet e grantit qeveritar përbëjnë 77.64% të buxhetit. Të hyrat vetanake në shumë prej 6.183.551 euro ose me 13.42%. Të hyrat e bartura nga viti 2026 janë 3,874,021.60 euro, që në buxhetin total marrin pjesë edhe Donacionet e brendshme janë 25.472.30 euro, dhe donacionet e jashtme 220.592.48 euro. Sa i përket shpenzimeve të këtij buxheti, shpenzimet e përgjithshme buxhetit për periudhën janar- qershor 2026 kapin shumën prej 18,793,479.16 dhe paraqesin një realizim të planit prej 40.79%. Pjesën më të madhe të këtij buxhetit e merr kategoria e pagave dhe meditjeve që ka shumën prej 12,263,108.63 euro dhe plani për këtë kategori deri në këtë periudhë është realizuar 57.50%. Mallra shërbime janë shpenzuar 2,679,561.56 ose 14.26%. Shpenzime komunale janë shpenzu 632,045.40 euro. Subvencione dhe transfere shënojnë një dinamikë më të ngadaltë për 45.36% dhe arrijnë shumën 410.130.000 ndërsa plani deri në këtë periudhë është realizuar 29.63% në këtë kategori. Kurse kategoria e kapitaleve, investimeve kapitale arrijnë vlerën 2,808,633.57 euro. Sa i përket të hyrave, komuna e Pejës sipas planit ka planifikuar të hyra prej 6,183.550 euro. Gjatë periudhës janar-qershor janë realizuar të hyra vetanake në shumë prej 2,904,948.65 euro që plani për vitin 2026 është realizuar 46.98%. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar gjoba nga gjykata në shumë prej 35.000€ dhe gjobat nga trafiku në shumë prej 554.000€ ose 15.64% në shumën e gjithëmbarshme të hyrave. Dinamikë të hyra të gjithëmarshme në periudhën raportuese arrijnë vlerën prej 3,541,347.88euro. Duke qenë se raporti është informativ dhe e keni pranu të detajuar, nuk do të zgjat më shumë detaje.

Z.Drin Veselaj: gjatë këtij analizimi të këtij raporti për realizimin e të hyrave dhe shpenzimin e tyre, unë i kam vërejt disa ndryshime që kisha pas dëshirë me i potencu. Për shembull, akomodimi për udhëtime zyrtare jashtë vendit, vitin 2025 në gjashtë mujorin e parë kanë qenë 200€ shpenzime, ndërsa tani në këtë gjashtë mujor janë 10,754 euro që është një rritje goxha e madhe e shpenzimeve të parasë publike. Mandej, furnizimi me pije dhe ushqim vitin e kaluar ka qenë 38.900 euro, ndërsa tani është 52.393 euro edhe këtu kam vërejtur një rritje jashtëzakonisht të madhe. Sa i përket investimeve kapitale, për mua kjo mbetet shqetësimi kryesor për shkak se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë shpenzuar afërsisht 5 milion, ndërsa tani nga granti qeveritar janë të shpenzuar vetëm 2.4 milion e që nëse e përkthejmë edhe në përqindje tejkalon 50% in e mos realizimit. Në anën tjetër ne jemi dëshmitarë që janë shumë projekte të filluara të mbetur në gjysë duke ja shtuar edhe atë pjesën që kryetari tha nuk mundet pa u zotuar mjetet me fillu me procedura. Unë e mendoj që kjo është dashur me ndodhur shumë më herët për shkak se janë fillu me qindra projekte edhe nuk janë përfundu. Edhe kjo mirë që paska marrë fund edhe tash ato që i nisni i zotoni paret edhe e filloni projektin. Pjesa tjetër është plan buxheti total I të hyrave vetanake është te investime kapitale 3,700.000, ndërsa të shpenzume ose të realizuar për këtë gjashtë mujor janë vetëm 47.000 euro. Po mendoj që është një diskrepancë jashtëzakonisht e madhe edhe është mirë që me fillu me që veç që mjetet janë në dispozicion me fillu me i

përfundu projektet që janë nis, edhe me pas mandej për vitin e ardhshëm një start të mbarë e të mirëfilltë që mos me ardhë në situate kur një projekt duhet me zgjat me 10 vjet ose 15 vjet. E përfundojmë një e bëjmë qysh duhet edhe mandej e fillojmë tjetrin. Kishte me qenë mirë që te kjo pjesa e investimeve kapitale, kuptoj që gjatë një periudhe ka pasur problem financiare për shkak të përmbaruesve, mirëpo kjo gradualisht edhe pse ka qenë ndoshta keq planifikim. Grradualisht ka filli shku duke u përmirësu gjendja dhe tash mjetet të cilat janë në dispozicion është mirë që të kryhen pagesat të vazhdojnë punët e projekteve që janë nis edhe të vijmë te ky planifikimi që e keni parapar ju vetë si ekzekutiv.

8.Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Pejës për vitin 2025 dhe plani i veprimit për të gjeturat e auditimit të vitit 2025.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: po e hapim diskutimin nga anëtaret e kuvendit.

Znj. Vlera Kuçi: nga raporti i auditimit e shohim se komuna e Pejës ende ka probleme me menaxhimin e financave publike dhe zbatimin e rregullave dhe ligjeve mbi menaxhimin e pasurisë dhe paras publike. Për vitin 2025 auditori i përgjithshëm ka dhënë opinion të kualifikuar për pasqyrat financiare dhe konkluzion të kualifikuar për pajtueshmërinë. Kjo do të thotë se gjatë auditimit janë konstatuar keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare dhe mospajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi. Si çështje kryesore janë klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në vlerë prej 555,020 € ku vendimi i gjykatës për zbatimin e kontratës kolektive nga investimet kapitale janë paguar 215,479€ dhe nga mallrat dhe shërbimet 60.118 euro dhe me vendim të gjykatës shpronësimet nga investimet kapitale janë paguar 1,098.688€, ku shuma prej 279.423 euro është dashur të paguhet nga kategoria mallrave dhe shërbime. Kemi çështjen tjetër që është mbivlerësimi i pasurisë komunale në vlerë prej 4,351.051€. Dy pagesa me vlerë reale 53.138 euro janë regjistruar gabimisht nga zyrtari si 5,313.978€ duke ndikuar në mbivlerësimin e pasurisë komunale. Projekti asfaltimi i rrugës Shtupeq i Madh Rugovë me vlerë 1,254.881€ edhe pse ishte pranuar teknikisht që në vitin 2020, nuk ishte bartur në regjistrin e pasurive komunale. Po ashtu palestra në Zahaq me vlerë 855.855€ nuk është regjistruar si pasuri në përdorim dhe pse ishte pranuar teknikisht. Kemi edhe mbivlerësimin e obligimeve të papaguara në vlerë prej 30.610€ si rezultat i evidencave jo të plota dhe jo të sakta ku pasqyrat financiare janë prezantuar si obligime të viteve të mëhershme por nuk janë ofruar dëshmi! Me ç'rast kur është kërkuar konfirmim nga operatori ekonomik përmes e-mailit ka deklaruar se komuna nuk ka fare obligim ndaj tij. Auditimi po ashtu ka evidentuar mangësi të tjera në administrimin e pronës komunale, në nivelin e ulët të inspektimeve të pronave, në menaxhimin e subvencioneve, administrimin e kontratave, mosregjistrimin e pagesave nga palët e treta në SIMFK, moskonfiskimin e sigurisë së ekzekutimit pas ndërprerjes së kontratave, vonesa në pagesat e fakturave dhe në realizimin e projekteve kapitale, rritjen e llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë si dhe mos zbatimin e menaxhimit të kontratave përmes platformës së e-prokurorimit. Shqetësues mbet fakti se ky raport përmban 12 rekomandime prej të cilave shtatë janë të përsëritura, një pjesërisht të përsëritur dhe katër janë të reja. Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e problemeve të evidentuara nga auditimet e viteve të kaluara nuk janë zgjedhur, por po përsëriten nga viti në vit. Pyetja ime sot është sa do të jetë i zbatueshëm ky plan që na është prezantuar sot pasi del që viteve të tjera nuk është zbatuar?

Z.Drin Veselaj: me të gjitha këto të cilat i potencoi kolegja Vlera, pyetja ime është konkrete a na përjashton kjo automatikisht nga mundësia e përfitimit të grantit të performancës kryetar? Për shkak se të gjeturat të cilat janë përsëritur edhe të treja që janë, a shpresoni që keni me mujt me i adresu këto çështje edhe me qenë pjesë e grantit duke i përfshirë këtu edhe disa vendime të cilat ministria i ka kthyer si të jashtëligjshme. A mendoni që gjatë kësaj periudhe me kolegët e ekzekutivit që i ke, me mujt me i adresu këto çështje për me qenë pjesë e grandit të performances?

Kryetari Gazmend Muhaxheri: unë u mundova me të shpjegu, nuk o faji i komunës që përmbaruesit ja marrin buxhetin prej pikave ku mbërrin me i marrë. Ligjërishtë janë të obliguar me i marrë prej pagave. Ligji e ka thënë ashtu. Edhe arsimtarët edhe këta mjekët që i kanë marrë pagat domethënë kanë lyp rritjen paga, rritje në shujt edhe krejt që dashur me i marrë prej kodit të pagave. Ligji për financa e ka thënë, po Ministria e Financave nuk ka dashur me ju dalë ndihmë komunave. Dëmi ka shku përmbi 150 milion euro, ndoshta e kap 300 milion euro edhe ata kanë me u marrë kush e ka pas fajin, kush s'e ka pas faj. Po paret ju janë marrë komunave. Komunat e kanë paditur qeverinë edhe ndoshta në një gjykim e fitojnë. Po ndoshta mbas pesë vjetëve. Tash kush është në qeveri, e kush është në opozitë atëherë s'ka me u dit, po dikush ka me u dasht me i pagu këto dëme që janë bërë në kohën reale tash komunave. Sidomos komunës së Pejës janë humbur dy ambulanca, një shkollë, një salle e sportit. Po kjo ka që fati 15 milion 600.000 euro nuk kanë mund me u marrë kështu, ku kanë mujt me i marrë i kanë marrë, edhe kryesisht që janë mundu me na dëmtu. Kjo është ajo çka mund me thënë unë edhe çka duhet me thënë si kryetar i komunës. Edhe kjo mundet me na kualifiku se mbi shumën e caktuar kur t'i merr prej buxhetit që s'është adekuat, prap ta kualifikon buxhetin. Po këtë vjet asnjë komunë nuk është kualifikuar për grantin e performancës as një komunë se ka fitu pasi tash ju ka ardh komunave tjera ajo qka kemi pagu na si komunë.

Znj. Ilirjana Gafuri: a përfundon vitin e ardhshëm kjo apo e njëjta na pret edhe vitin e ardhshëm?

Kryetari Gazmend Muhaxheri: ndoshta do të ketë reflektim edhe do të hiqet kushti i kualifikimit të opinionit publik për buxhet komunal. Nëse nuk e heqin se kjo ka qenë kërkesë e demosit zvicerran. Komuna e Pejës ka qenë lider kur ata e kanë bërë matjen edhe performancën grantin e kanë nda, prej se ka kalu në qeveri ka ndëru pak puna. Dy herë të mira e kemi fitu tash këto dy vjet s'jemi tu fitu, po ish dasht me pas njëfarë drejtësie në këtë punë edhe me e heq këtë kusht që s'mundet me përmbush tash asnjë komunë e Republikës së Kosovës.

Z.Drin Veselaj: këto që tha kryetari unë paraprakisht e potencova që ne po e dimë problemin me kontratë kolektive, mirëpo këtu janë 12 të gjetura e një prej tyre është që kjo e që i ka marrë përmbaruesi paret. Po tash në këtë rast përmbaruesi nuk ka të bëjë me keqmenaxhimin e ndarjes së subvencioneve. Ne e dimë qysh bëhet auditimi. Këto shkojnë si mbas mostrave ai nuk t'i ka marrë krejt lëndët me t'i kontroll, se me bë me hy me i kontrolluar lëndë për lëndë jo 12 gjetje veç fiks një 500 gjetje i kishe pas, a e din e grandin e performancës për këtë shekull e kishim harru.

Kryetari Gazmend Muhaxheri: mbasi e kanë kryer raportin janë kryer edhe dy muaj ditë du i thënë gjeni gabime diçka kryetarit gjeni diçka gabim jo sa e ka obligim me i marrë, po 10fishin e obligimeve që i ka pas me i marrë, i ka marrë që kjo unë çka po të them që është tendenca po s'kanë çka me bo krejt çka kanë mujt me gjet i kanë bë e me krejt qato janë 12, e qato nuk e kualifikojnë raportin e auditimit të komunës së Pejës e kualifikon veç ajo puna e përmbaruesit që aty komuna e Pejës nuk e ka asnjë hak asnjë hile asnjë gabim.

9.Shqyrtimi i informatës nga DKA për përfundimin e vitit shkollor, testit të arritshmerisë dhe testit të maturës.

Z.Naser Gega: te arsimi nuk është diçka që s'e dimi. E dini ju se të gjithë kemi o motra o vëllazën o fëmijë kemi nëpër shkolla e dimë realitetin. Kur duan me u regjistruar të gjithë intervenojmë prano ma mos ma prano. Kur duhet me kalu o kalo ma mos ma kalo. Kur duhet me pranuar në punë prapë o prano mos e prano. Vazhdimisht bëjmë përpjekje që në çdo situatë me bë zgjedhje më të mirë të mundshme. Në kuadër të detyrave dhe të cilat ka pas gjashtë mujori i parë ka pas punë shumë. Vazhdimisht duke fillu me furnizim me pajisje didaktike të shkollave me furnizim me për ngrohje për situata të tjera. Bashkëpunim me OJQ- të ndryshme kemi pasur vazhdimisht, bashkëpunim me institucionet përkatëse të gjerësisht që kanë të bëjnë me arsimin. Mirëpo ajo që është e rëndësishme pos, tjerash është testi i maturës dhe arritshmërisë risi në në këtë drejtim. Veq tjerë desha të them është renovimi komplet bëhet këtë verë i shkollës së paralelës në Dardani atje se ka shumë mangësi. Do të bëhet renovimi i kulmit në Novosell parketi, do shtrohet në palestrën sportive , edhe në shkollën teknike. Ka investime të tjera palestra e sporteve ka ndërtohet në Trestenik dhe ka investime teknike në shkollë. E jona është që me bë maksimumin si DKA, si mësimdhënës dhe si prind të gjithë së bashku që të arrijmë suksese sa më të mira dhe jo çdo herë jemi të kënaqur në këtë drejtim. Sa i perket testit të matures komuna e Pejës ka aritur kalushmerinë me 75% që është një përqindje e përfaert me vitin e kaluar. Shkolla e mesme mjeksisë ka arritur 91.95, gjimnazi 87.15%, shkolla "Rifat Gjota" 48.99%, shkolla "Odhise Paskali" 72.15%, shkolla "Ali Hadri" 46.97%, shkolla "Halit Kasapolli" 66.7%, Cambrigde 66%, Euroschool 62%. Suksesin më të mirë e të sukseshëme e ka Gjimnazi "Bedri Pejani" edhe shkolla e mesme e mjeksisë. Kur është tek testi i maturës jemi të kënaqur me rezultatet e arritura, mirëpo nuk vlen e njëjta edhe për testin e arritshmërisë. Për shkak se këtu po kemi pakënaqësi deri momentin e fundit ministria ka thënë se nuk do të mbahet testi i arritshmërisë, momentin e fundit thanë do të mbahet. Te testi i aritshmërisë komuna e Pejës ka arritur 46.4 në nivel të Kosovës është 48.35%, edhe vitin e kaluar nuk e ka kaluar 50% as në nivel Kosovës as nivel komuna. Mirëpo këto nuk janë vetëm përqindje të thata, mirëpo varësisht prej situatës dhe nxënësve ku i kemi dhe ku i kanë shkallësitë e tyre për shkak se ata janë të preorientuar fillimisht në drejtime të caktuara, lëndë shkencore ka ngecje më tepër për dallim prej lëndëve shoqnore. Lënda gjuha angleze ka pas sukses të mirë që është një shenjë se nxënësit gjuhën angleze janë ka kultivojnë pak më tepër. Këto janë gjitha sa i perket pikes së rendit të dites, nese ka dikush ndonjë pyetje këtu jam.

Z.Labinot Panxha: unë me kujdes e kam analizu këtë publikimin që keni bërë nga drejtoria juve. Edhe e kam ngritur këtë shqetësim të përqindjes të cilën e përmendi edhe kolegu edhe në facebook me një reagim, ku pas atij reagimi më kanë kontaktuar disa mësimdhënës por edhe drejtorë të disa shkollave fillore. Unë mendoj që për mua por edhe për të gjithë neve është

shqetësuse përqindja kaq e ulët në shkollat fillore, sidomos në ato ku janë në vendet rurale. Për shembull totali prej 26 shkollave publike sa janë, vetëm gjashtë prej tyre e kanë kaluar 50%, të gjitha të tjerat janë nën 50%. Mendoj që duhet me qenë shqetësuese si për mua ashtu dhe për të gjithë neve që jemi këtu në këtë seancë. Shkolla Cambrigde ka rezultatin më të mirin në nivel komune. E kam fjalën për shkollën fillore edhe është e para. Tash me këtë a po japet një mesazh që shkollat publike nuk e kanë nivelin e arsimimit ashtu si shkollat private, dhe a duhet qytetarët me u fokusu te shkollat private me regjistru fëmijët. Drejtor, e përmende që në shkollat fillore nxënësit po e mësojnë gjuhën angleze në mënyrën më të mirë të mundshme, por nuk e di a je në dijeni se në shkollën fillore Migjeni në Gllogjan që ka veç 31.87% të testit të arrishmërisë, aty nuk ka profesoreshë ose arsimtare të shkollës të gjuhes angleze dhe ato prej muajit shkurt të këtij viti nëse nuk gaboj. Zyrtarisht janë 140 profesor, profesoresha si tepricë në komunën tonë por çuditërisht në shkollën fillore Migjeni në Gllogjan nuk ka arsimtare të gjuhes angleze. A je në dijeni për këtë? Edhe në reagimin tim që e kam bërë në rrjetet sociale kam thënë a ka bërë dikush një analizë në lidhje me këtë përqindje, dhe çka ka ndikuar që kjo përqindje është kaq e ultë! Po si unë ashtu edhe Aleanca, po edhe të gjithë neve këtu jemi të gatshëm me kontribu në çdo aspekt në mënyrë që me u rrit niveli i arsimimit në i cilësisë në këto shkolla. Unë mendoj që nëse ishin ndalë punësimet nga pak me të njohshëm dhe ishin shku në mënyrë meritore, sigurisht që edhe cilësia do të ishte më e madhe.

Znj. Vjendita Kelemendi Gërgoci: jemi te pika e rezultateve të testit të arrishmërisë edhe testit të maturës.Unë në fakt këto nuk i shoh si arsye me i fajësu mësimdhënësit apo nxënësit, por e shoh sikur një tregues që kjo çështje duhet të analizohet seriozisht. Do të thotë çfarë mbështetje drejtor do t'u afrohet shkollave që i kanë rezultatet më të ulëta. A do të ketë programe të shtesë? A do të ketë trajnime të orientuar sipas nevojave reale? A do të ketë konsultime dhe mbështetje për nxënësit? Si dhe një mekanizëm me përcjellë rezultatin gjatë vitit në mënyrë që kur të vjen koha e testeve me qenë në dijeni si është situata edhe të punojmë paraprakisht për ngritjen e rezultateve dhe sigurimin e cilësisë, paraprakishtë në të gjitha shkollat e komunës së Pejës. Gjithashtu a po e masim suksesin e investimeve në arsim me shumën e parave që po shpenzojmë apo me ndryshimin real që ato investime sjellin dijen dhe rezultatet e nxënësve.

Z.Drin Veselaj: e kuptoj që kjo pikë ka më shumë të bëjë me rezultatet e testit kombëtar të arrishmërisë, mirëpo meqë drejtori është këtu e kisha shfrytëzu rastin me ngrit një çështje që për mua, po edhe për shumë prindë dhe qytetarë është jashtëzakonisht i rëndësishëm e që ka të bëjë me arsimin. Ne e dimë që donatorë të ndryshëm edhe institucione të ndryshme kanë investu jashtëzakonisht shumë në ngritjen e kapaciteteve për asistent për fëmijë me nevoja të veçanta. Sipas informatave që unë kam, ekzistojnë rreth 20 profesionistë të kësaj fushe të cilët janë të kualifikuar dhe çertifikuar në komunën tonë. Gjithashtu ju është premtu që gjatë muajit maj ka me u hap konkursi, që ata me u angazhu në profesionin e tyre për çka edhe janë kualifiku edhe janë çertifiku. Mirëpo deri më tani me sa unë kam informatë nuk ka ndodhur një gjë e tillë edhe pse është fundi i muajit korrik. Pyetja ka të bëjë drejtpërdrejtë me ju drejtorë a do të ketë konkurs para fillimit të ri shkollor, pasi që ne e dimë që është jashtëzakonisht e nevojshme që këta njerëz këta profesionistë të angazhohen nëpër shkolla. E di që këta 20 nuk mjaftojnë për të plotësu të gjitha nevojat, mirëpo të paktën me fillu një rrugë edhe në të ardhmen me u rrit numri i këtyre profesionistëve. Pyetja është direkte a do të ketë konkurs para fillimit të vitit të ri shkollor apo jo? Për këtë pjesën edhe nëse është ndonjë prej informatave të cilat unë i kam nuk

qëndron. Kisha pas dëshirë me dit cila është ajo pjesë edhe sigurisht që me bashkëpunim edhe me të gjitha këto të tjerat, ne kishim mujt me i çu këto procese e që në të ardhmen këta fëmijë të cilët kanë jashtëzakonisht nevojë me u inkorporuar sa më shumë në sistemin arsimor. Gjithashtu edhe te pjesa e rezultateve sigurisht që këto bashkëfajtorë janë të gjithë nga pak. Mirëpo momentin që sidomos për testin e arritshmërisë kur diskutohet se do të ketë ose nuk do të ketë edhe fëmijët sigurisht që përgatiten për mos me pas test edhe ndodh në fund. Mandej kjo edhe i dekoncentron i dekorajon të gjithë ata edhe mundet me qenë një prej elementeve që mos me pas rezultate të kënaqshme, sidomos në shkollat fillore. Ne e dimë që mjekësia dhe gjimnazi janë shkolla me fokus të veçantë prej nxënësve, edhe prej profesorëve edhe prej institucioneve me të cila të cilat e udhëheqin. Mirëpo kishte me qenë mirë që ne me inkurajuar nxënës të tjerë që me pas mundësi ata me shkuar edhe në shkolla profesionale edhe me ngrit kapacitetet edhe në ato shkolla. Mirëpo ndoshta duhet bashkarisht me e gjet një mundësi me kriju një platformë, që me i motivu ata me shku në shkolla profesionale edhe me barazu këtë rezultatin ne të gjitha shkollave të mesme.

Z.Naser Gega: të them të drejtën kur dolen rezultatet e testit të aritshmërisë ne kolegët në drejtorat biseduam pas analizave të tjera sjemi ekspertët me dit se çfarë mirëpo me ata bazike çfarë kemi edhe thashë gjithsesi këto të publikohen në faqen zyrtare të drejtoratit të arsimit. A janë të mira a janë të këqija ajo është domethënë pjesë e punës tonë punës time me staf por edhe gjithë shkollave. Po e dyta në Gllogjan që e the anglisht aty ka qenë një magjistre e gjuhës angleze , ajo kaloi pastaj këtu në teknike. Se me magjistër gjuhës angleze me fakultet shtetor, jo me privat të them të drejtën një muaj shkoj deri mbas asaj, e kam sinjalizuar edhe kam kërkuar prej dikujt tjetër me shku atje. Diku një muaj pa përfunduar në fillim të majit dikur më kanë thënë që nuk ka shkuar ai person. Mbështetje po ka vazhdimisht pos tjerash është programi School Me që është një program jashtëzakonisht i kushtueshëm për komunën e Pejës dhe ai program është kur njësitë mësimore janë të zbërthyera pastaj edhe në miniaturë të njëjtën kohë mund të ushtrojnë nxënësit në të, mund të krijojnë ndonjë kuizë, mund të mbajnë kontakt me të tjerët dhe ato mund t'i promovojnë në mënyrë të pavarur. E keqja është që shumë pak po përdoret nga nxënësit dhe ndonjëherë dhe mësimdhënësit nuk e kanë atë trysninë e mjaftueshme se si do të shkojë më tutje. Te punësimet vazhdimisht konkurset dhe punësimet është temë e cila diskutohet. Mirëpo një temë që e kam thënë vazhdimisht dhe e them është që ai i cili është i mirë nuk ka nevojë me fol me askend. Çdo here ai që e ka maksimumin e pikëve në test nuk më ka interesu kush është si mua ashtu edhe DKA-së, ai është sistemu në procesin arsimor. Tek konkursi për asistent ministria tash veç me të thënë që këtë muaj bashkë për çdo ditë i bie në mend që lyp shënime edhe këtë shënim edhe atë shënim, edhe këto edhe këto. Mirëpo unë e shoh këtë jo si shënim që vërtetë ka një strategji, mirëpo si një diçka që i ka kaplu një lloj paniku. Në arsim duhet me ndërru kurrikula, duhet me ndërru një formë e punës krejt tjetër, jo në këtë formë kështu që e kemi. I përmenda asistentët, unë temë e kam ngritur vazhdimisht te asistentët për shkak se vërtetë kem nevojë për asistenta në shkollë. Vërtetë fëmija ka nevojë për mbështetje për asistenta, mirëpo shtrohet pyetja, cili është rezultati? Ndoshta e mbërrimë një rezultat te ai fëmijë cili është rezultati që po e mbrim me fëmijë të tjerë brenda kësaj klase? Është një temë tjetër ku një fëmijë tjetër thotë një fëmijë me nevoja të veçanta thotë nuk shkon në këtë shkollë duhet me më çu në shkollë tjetër, e çon në shkollë tjetër edhe i thotë nënës, duhet të i marrim asistentin veç ashtu, fëmijët pranon me çu në shkollë atje i thotë nënës së vet me një kusht a ka me pas se dikë ndonjë ngat me më ndihmu tha me qesh krejt klasa me mua, ai s'ka qesh kërrkush me të, mirëpo fëmija ndërgjegjen vet ne harrojmë që edhe fëmija e ka identitetin e vet. Domethënë a duhet gjithqysh me ja lënë atij mbështetësin. Sa i perket punësimeve ne i kemi

180 të punësuar tepër dhe ministria thotë mundeni këta me i mbajt në proçes mundeni me i mbajt në punë ju këta 180 nëse ju keni pare si komunë . Këtë vit i ka pagu kryetari një pjesë, por vitin e ardhshëm ka me qenë një tërmet. Asnje konkurs nuk e kemi hapur ketë vitë.

Znj.Vjendita Kelmendi Gërgoci: cili është plani i DKA-së për menaxhimin e kësaj situate? A po shqyrtohet ndonjë formë e riorganizmit apo ndonjë zgjidhje tjeter?

Z.Naser Gega:unë e them kur i kemi marrë pozitat na ka pëlqyer ndoshta, mirëpo edhe kur nuk të pëlqen situata ke me u ballafaqu me ato. Tek këta 180 kush vjen shprehje këtu parimisht në një vijnë ata që nuk janë të kualifikuar, të gjithë ata që s'janë të kualifikuar. Nën dy vijnë ata të cilët kanë performancë të dobëtë. Nën tre vijnë ata që kanë stazh më tepër. Tash performancën me stazh nuk po ju pëlqen me komentu kërkush edhe thonë këtë performancë, kush e ndërton? kush na vlerëson neve? Këtë performancë e ke vlerësu veten, është performanca bazike. Performancë të vetën pa marrë parasysh që i ka 20 vjet stazh e tjetri i ka pesë vjeç stazh, po është 100 herë më saktë ky pesë vjeç e merr prioritetin.

10.Pyetjet dhe propozimet lidhur me punën e Komunës, të ngritura nga anëtarët, në atë rënditje siç jan pranuar.

Kryesysi Rexhep Kurtbogaj: çështje të ngritura me shkrim ka ardh nga znj.Gentiana Bajrami Atashi.

11.Çështje të ngritura në mbledhje nga udhëheqësi apo nga anëtarët e Kuvendit.

Znj. Gentiana Bajrami Atashi: përmes kësaj kërkese kërkoj nga drejtoria për punë komunale dhe shërbime publike që të shqyrtojë mundësinë e vendosjes së kalimeve për kombësor, zebrave dhe pengesave për ngadalësimin e shpejtësisë, pra policëve të shtrirë në rrugën "Zhuj Selmani" dhe "Jeton Dedushaj" në lagjen Kristal. Këto rrugë karakterizohen nga qarkullimi i konsiderueshëm i automjeteve, ndërsa në to lëvizin çdo ditë një numër i madh banorësh, përfshirë fëmijë dhe të moshuar. Po ashtu në këto rrugë kanë ndodhur edhe aksidente të shumta trafiku që ndikojnë dhe besoj që këto janë të domosdoshme që të merren masa parandaluese, që do të ndikonin në uljen e shpejtësisë së automjeteve, rritjen e sigurisë rrugore dhe parandalimin e aksidenteve. Duke pasur parasysh rëndësinë e sigurisë së qytetarëve, kërkoj që kjo çështje të trajtohet me prioritet dhe pas vlerësimit të gjendjes në terren të ndërmerren masat e veprimit të nevojshëm për realizimin e këtyre ndërhyrjeve.

Z.Islam Husaj: unë i kam tre çështje kërkoj që sa më parë të fillohet me plotësim ndryshimin e rregullores për dekoratat dhe mirënjohjes dhe rregullores për këshillat lokal. Këshillat lokal në tetor të këtij viti e përfundojnë mandatin që e kanë dhe ne ende nuk e kemi rregulloren si duhet! Nuk është hera e pare shumë herë që po kërkoj, po nuk po merret iniciativa që të formohet një komision edhe të fillohet. E dyta në dy seanca para kësaj ne kemi aprovuar disa komitete edhe është detyrë e juaja si kryesues dhe e kryeshef i kuvendit me i konstitu këto komitete, me i thirrë në takim me zgjedhë kryetarin komitetit dhe mandej ata punojnë vetë por fillimisht duhet! E treta

është kërkesa në planifikimin e buxhetit këtë vit që e kemi në shtator sigurisht planifikoni mjete për qet zerim se nuk nuk shkon kështu, nuk na ka hije ne si komunë që sa vite ende jemi me këto telashe në zë në komunikim.

Znj.Ilirjana Gafuri: edhe unë kam një kërkesë, po kujt me j'a bë kërkesën? Drejtori i shërbimeve publike sot nuk ishtë fare këtu. Po ju pyes mbasi vetëm ju jeni këtu edhe Naseri është edhe kolegëve të mi, a keni kalu nga rruga e Jarinës? A po ju bjen sidomos tash me kalu andej? A po mundeni me kalu andej? Është një hall i madh edhe ajo pjesë don urgjentisht jo tenderime duhet krejt këto me i tejkalu, po duheni me gjet një zgjidhje edhe rruga me u rregullu. Merrni seriozisht këtë punë ftesë për drejtoratin përkatës për me gjet zgjidhjen për rrugën e Jarinës.

Z.Elbasan Krasniqi: desha të ngris një çështje serioze sa i përket projektit të autostradës Kjevë-Zahaq. Posaçërisht në fshatin Kliqin kanë qenë dy projekte , një rrethrotullim për automjete dhe tjetra ka qenë nënkalimi për nxënës të shkollës fillore "Naum Veqilhharxhi". Mirëpo me të marr informatën nga punëkryesi shihet që janë tërhequr të dyja ato projekte prej aty, kështu që nxënësit për të vijuar mësimin në ketë shkollën fillore ata sigurisht do të mundohen të gjejnë opsione të tjera për të kalu rrugën. Unë e shoh një gjë të shqetësuese se aty mund të ketë edhe raste me fatalitet, mund të ndërrojë jetë ndonjë person aty gjatë të kalimit të rrugës në mënyrë jo të ligjshme. Kështu që unë kërkoj nga kuvendi dhe nga ju kolegët e mi që të m përkrahni t'i drejtohemi organeve kompetente që të rikthehen prapë projektet siç ka qenë në fillim.

Z.Labinot Panxha: propozimi për emërimin e zëvendës kryesuesit të këtij kuvendi ju pata tregu këtu që është i kundërligjshëm. Kryetari i komunës më tha jo është në rregull. Mirëpo unë i pata shkru letër MAPL-së dhe ata e kanë kthye se zëvendës kryesuesi i kuvendit komunal në Pejë është i emëruar kundërligjshëm dhe si i tillë unë konsideroj që edhe kryesuesi edhe kryetari i kuvendit duhet ta tërheqin propozimin dhe ta lirojnë atë pozitë sepse ajo pozitë është kundërligjshëm.

Kryesusi Rexhep Kurtbogaj: edhe unë e kam një përgjigje për z.Islami, në seancën e kaluar i kemi informu këto komitetet edhe e kemi pritur 30 ditë afatin e ligjshmërisë pastaj me i ftu në takim.

Meqë u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës e propozime tjera nuk ka pasur, kryesuesi z. Rexhep Kurtbogaj e shpalli të mbyllur këtë takim të kuvendit, në orën **13:40** h.

Video incizimi i këtij takimi të Kuvendit të Komunës së Pejës në kanalin zyrtarë në Youtube.

Kliko:https://www.youtube.com/watch?v=5xlEmmTQwTU
https://www.youtube.com/watch?v=fF_I_R58Q5I

Procesmbajtësja,

znj. Donjeta Morina

KRYESUES I KUVENDI,

z. Rexhep Kurtbogaj